REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Nr. 17 Prot. Datë 3.01.2019

Drejtuar: **Znj. Marinela Jazoj,**
Drejtor Ekzekutiv i FIAA, Foreign Investors in Albania
Tiranë,

Për Dijeni: **Z. Ardit Kamberi**
Drejtues i Sekretariatit EITI Shqipëri

TIRANË

Lënda: Për zëvendësimin e Anëtarit përfaqësues të Statkraft me Albpetrol sh.a. në Bordin EITI (MSG) – "Nisma për Transparencë në Industritë Nxjerrëse".

E nderuar Znj. Jazoj,

Në kuadër të implementimit të Nismës për Transparencën në Industrinë Nxjerrëse - EITI Shqipëri, në përgjigje të zbatimit të Standardit Ndërkombëtar EITI dhe në mbështetje të *Urdhrit të Kryeministrit Nr. 71, dt 21/07/2011 "Mbi funksionimin e grupit ndërinstitucional të punës si vend zbatues i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse"*, Grupi Ndërinstitucional i Punës (MSG) punon si strukturë drejtuese dhe koordinuese për çështjen EITI në Shqipëri.

Duke u bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të lidhur mes EITI Shqipëri dhe FIAA ***Nr. 118 Prot, datë 16. 11. 2016,*** në të cilin është përcaktuar se FIAA do të jetë i vetmi entitet përfaqësues i Industrisë Nxjerrese, i cili do të zhvillojë procesin e zgjedhjes së anëtarëve në MSG nga kompanitë, duke garantuar kështu një proces përzgjedhje të pavarur dhe transparent, ju vemë në dijeni se anëtarja e caktuar nga ju si përfaqësuese e kompanisë Statkraft në MSG, Znj. Orkida Dragoti, në datën 11. 01. 2019 ka dhënë dorëheqjen për arsye pune nga pozicioni i saj në MSG.

Në kushtet e nevojës së dalë nga Procesi i Validimit EITI dhe Correctiv Actions që Bordi EITI ka përcaktuar për Shqipërinë, për futjen e kompanisë shtetërore Albpetrol Sh.a. si anëtare me të drejtë vote në MSG, lutem të merrni në konsideratë kalimin e një përfaqësuesi tjetër të kompanisë Statkraft, si kontribues i përhershëm i proceseve EITI dhe zëvendësimin e tij me përfaqësuesin që do të përcaktohet nga Albpetrol Sh.a.

Për sa më sipër, do të vlerësonim angazhimin për dërgimin e një përgjigje zyrtare nga ana juaj brenda datës **28 Janar 2019.**

Lutem dërgoni përgjigjen tuaj për dijeni edhe në adresat:

Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI)
Në vëmendje të: Z. Ardit Kamberi, Drejtues i Sekretariatit Shqiptar EITI

Email: ardit.kamberi8@gmail.com

Dhe: emiliana.kola@albeiti.gov.al

Ju faleminderit për bashkëpunimin,

KRYETAR I MSG EITI ALBANIA
dhe
ZV/MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

ENIS ALIKO